



SYLLABUS I LËNDËS “SISTEMATIKË DHE BOTANIKË E PYJEVE”

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit		
Titulli i lëndës:	Sistematikë dhe botanikë e pyjeve		
Programi:	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (SHPM)		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Detyruese (Obligative)		
Viti i studimeve:	I (i parë), semestri i dytë		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Do te percaktohet		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Bekim Gashi		
Të dhënat kontaktuese:	Tel: +386/49 600 850 E - mail: bekim.gashi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në fillim të këtij kursi diskutohet për Botanikën si shkencë dhe karakteristikat themelore të bimëve dhe vazhdohet me Elementet e sistematikës dhe Fillet e sistematikës. Pastaj bëhet njohja e Taksonomisë dhe nomenklaturës (Kategoritë dhe njësitë taksonomike, Nomenklatura) në Sistematikën e bimëve. Theks i veçantë i vihet Klasifikimit të bimëve, përfshirë bimët e ulëta (<i>Thallophyta: Algat, Kërpuhat, Likenet</i>) dhe bimëve të larta (<i>Cormophyta: Myshqet -Bryophyta, Fierorët -Pteridophyta, Bimët me lule-farë - Spermatophyta</i>). Do të bëhet njohja e karakteristikave morfologjike, biologjike dhe ekologjike të llojeve bimore më të rëndësishme të pyjeve të Kosovës. Poashtu, u kushtohet rëndësi edhe llojeve bimore endemike dhe endemorelikte të pyjeve të Kosovës, përfshirë edhe llojet bimore të pyjeve të Kosovës nga Libri i kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës respektivisht nga Lista e Kuqe.</p>		
Qëllimi i lëndës:	Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t’u ofrojë njohjen e llojeve bimore me theks të veçantë bimëve nga pyjet e Kosovës.		
Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të diskutojnë lidhur me llojlojshmërinë bimore të Kosovës, 2. Të dinë më shumë për diversitetin floristik të pyjeve të Kosovës, 3. Të kuptojnë parimet bazë të shtrirjes horizontale dhe vertikale të llojeve bimore në Kosovë, 4. Të kuptojnë rëndësinë e pyjeve në funksion të ambientit dhe të shëndetit të njeriut, 5. Njohuritë e fituara t’i zbatojnë në teori dhe në praktikë 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15 javë	45



Ushtrime teorike/laboratorike	2	5 javë	10
Punë praktike	2	5 javë	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10 javë	10
Ushtrime në terren	5	4	20
Kollokfiume, seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10 javë	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10 javë	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	3 javë	6
Projektet, prezantimet ,etj	/	/	/
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ushtrime-ekspedita hulumtuese në natyrë, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, seminare, Vlerësime (I&II), provime.		
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 15%, Vlerësimi i dytë: 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Provimi praktik 10%, Provimi final: 50%, Total: 100%.		
Mjetet e konkretizimit	Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, material nga herbariumi etj.		
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	1.5:1 (3+2 orë).		
Literatura			
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rexhepi, F. (2007): The vegetation of Kosova. UP-FNS. Prishtinë. 2. Krasniqi, E. (2006): Flora dhe vegjetacioni i Malit Drenicë. Disertacion i doktoraturës. UP-FSHMN. Prishtinë. 3. Millaku, F. (2005): Praktikum i botanikës. UP-FSHMN. Prishtinë. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 4. Pajazitaj, Q. (2005): Sistematika e bimëve të larta (Bryophyta-Pteridophyta-Spermatophyta). UP-FSHMN. Prishtinë. 5. Rexhepi, F. (2002): Praktikum i botanikës (Botim i tretë i plotësuar). UP-FSHMN. Prishtinë. 6. Gecaj, A. (2001): Praktikumi i sistematikës së bimëve të ulëta. UP-FSHMN. Prishtinë. 7. Rexhepi, F. (2000): Bimët endemike të Kosovës. UP-FSHMN. Prishtinë. 		

	<p>8. Rexhepi, F. (1999): Botanika II (Sistematika e bimëve). UP-FSHMN. Prishtinë.</p> <p>9. Krasniqi, F. (1985): Sistematia e bimëve të larta me elemente të filogjenisë. ETMM i KSAK.Pajazitaj, Q. (2004): Përcaktues i bimëve Pteridofite & Spermatofite. UP-FSHMN. Prishtinë.</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Sistematika e bimëve	Mbledhja, fiksimi, konzervimi, preparimi dhe kultivimi i bimëve të ulëta – Mbledhja e algave
<i>Java e dytë:</i>	Bimët e ulëta; <i>Algat</i>	Bimët e ulëta – <i>Algat</i>
<i>Java e tretë:</i>	Bimët e ulëta; <i>Këpurdhat</i>	<i>Këpurdhat</i>
<i>Java e katërt:</i>	Bimët e ulëta; <i>Likenet</i>	<i>Likenet</i>
<i>Java e pestë:</i>	Bimët e larta; <i>Myshqet</i>	Mbledhja e bimëve të larta dhe përgatitja e herbarit
<i>Java e gjashtë:</i>	Bimët e larta; <i>Fierorët</i>	Bimët e larta – <i>Myshqet</i>
<i>Java e shtatë:</i>	Bimët e larta; Farëzhveshurat Vlerësimi i parë intermedier	<i>Fierorët</i>
<i>Java e tetë:</i>	Bimët e larta; Farëzhveshurat (organet e riprodhimit dhe kriteret e klasifikimit)	Farëzhveshurat
<i>Java e nëntë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Magnolidae</i>)	Farëveshurat (lulja, lulesat, frytet, farat)
<i>Java e dhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Hamamelidae</i>)	Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Magnoliidae: Aristolochia, Ranunculus, Papaver, Berberis</i>)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Caryophilidae</i> , dehe <i>Dillenidae</i>)	Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Hamamelidae: Platanus, Carpinus, Fagus, Quercus</i>)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Rosidae</i>)	Farëveshurat (Dikotiledonet – <i>Caryophyllidae: Silene, Chenopodium, Rumex; Dikuotiledonet – Dillenidae Paeonia, Tilia, Ulmus, Ficus, Viola, Helianthemum, Vaccinium, Primula</i>)



<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Dikotiledonet – Asteridae)	Farëveshurat (Dikotiledonet – Rosidae: <i>Rosa, Potentilla, Rubus, Prunus, Malus, Crataegus, Pyrus, Robinia, Trifolium, Cornus, Euphorbia, Acer, Juglans</i>)
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Monokotiledonet – Alismatidae dhe Liliidae)	Farëveshurat (Dikotiledonet – Asteridae: <i>Forsythia, Fraxinus, Stachys, Centaurea, Aster, Tussilago, Bellis, Achillea, Taraxacum</i>)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Bimët e larta; Farëveshurat (Monokotiledonet – Arecidae) Vlerësimi i dytë intermedier	Farëveshurat (Monokotiledonet – Alismatidae, Liliidae, Arecidae: <i>Tulipa, Fritillaria, Ruscus, Scilla, Allium, Crocus, Orchis, Luzula, Poa, Dactylis, Arum</i>)
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe në punë seminarike; Mbatja e qetësisë në mësim, çkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj.		